



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr.02
Prishtinë, më 24 Nëntor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, N-225
Mbledhja filloi në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Morën pjesë: Berim Ramosaj, Gjylnaze Sylja, Adem Salihaj, Ramadan Avdiu, Adem Salihaj, Zylfi Merxha, Nait Hasani, Rita Hajzeraj.

Munguan: Silopodan Petrovic

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Berim Ramosaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i fushëveprimit të komisionit.
2. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit.
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i fushëveprimit të komisionit.

Kryetari i Komisionit – Është një material në vija të trasha, i cili është material i stafit mbështetës, i cili ka informacione në lidhje me fushëveprimin dhe duke u mbështetur në normat sepse ky komision edhe është i formuar në bazë të disa dokumenteve. Hapësira është mjaft e gjerë në aspektin së përfshifshmërisë të punëve të këtij komisioni. Pa dashur te shtoj diçka lidhur me këtë pikë, e hap diskutimin se a keni diçka plotësuese apo ndonjë mangësi, nga fushëveprimi i propozuar. Me të vërtetë, nuk kam ditur se e kemi kaq fushëveprimin e gjerë sepse kam menduar që jemi të orientuar më tepër, me legjislacionin dhe respektivisht komunikimi me Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Duke marrë parasysh atë çfarë kemi nxjerrë nga rregullorja, që në fakt falënderojmë Nur Çekun për këtë, fushëveprimi është mjaft i gjerë.

Gjynaze Sylja- Në bazë të ligjit, sa kam lexuar për Forcën e sigurisë, normalisht del edhe fushëveprimi por do doja te ndalem pak te formulimi. Mos do të ishte më mirë meqenëse në secilën pik është **për,për,për** ta bëjmë “Komisioni për Forcën e Sigurisë së Kosovës është komision funksional ,Komisioni për Forcën e Sigurisë së Kosovës është përgjegjës për dhe pastaj me heq”.për dhe pastaj te shkruajmë “shqyrtimin,për ti kërkuar, kërkuar,shqyrtimin,shqyrtimin,d.m.th mos të përsëriten në secilin. Te pika C, konteksti i fjalisë duhet të ndryshohet “në mbledhjet e komisionit”,sepse thotë kështu “ Për të kërkuar nga Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës sekretari i përhershëm i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës të jenë të pranishëm në mbledhjet e tyre”, kur thuhet “të tyre” duhet “mbledhjet e komisionit”. Pika f) është pak e paqartë “për shqyrtimin të vazhdueshëm dhjetëvjeçar”, ndërsa në ligj është “shqyrtimin e planit dhjetëvjeçar rrotativ”. Mendoj më pak që me pak e specifikon, çfarë plani. Është e pa specifikuar sepse rrotativ shkruan ne ligj.

Nait Hasani- Ne tani e kemi miratuar buxhetin në parim, kështu që është më mirë të theksohet me urgjencë pika (d) për buxhetin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, a duhet ta rrisim, a nuk duhet ta rrisim. Buxheti është miratuar në parim por ne si komision kemi mundësi deri në lexim të dytë, për të bërë ndryshime këtu në Kuvend. Kjo le të mbetet si pikë urgjente.

Kryetari i Komisionit- Kjo pikë le të jetë, për mbledhjen e ardhshme si pikë e rendit të ditës.

Rita Hajzeraj- Te pika (f) “për shqyrtimin e planit rrotativ dhe të vazhdueshëm” është i ndryshëm apo për shkak të ligjit duhet të përshtatet me ligjin

Kryetari i Komisionit- Më mirë do ishte “për shqyrtimin e planit dhjetëvjeçar rrotativ” dhe pajtohemi të gjithë për këto plotësime.

Zylfi Mërxha-Duhet ta kemi përpara te gjithë fushëveprimin e Komisionit që ta dimë krejt se çfarë do të bëjmë. Pajtohem me diskutuesit.

Kryetari i Komisionit- Konkluzion, të bëhen përmirësimet në aspektin linguistik, me këto ndryshime që u kërkuan nga anëtarët e Komisionit. Për mbledhjen e ardhshme të kemi të qartë fushëveprimin, d.m.th edhe në aspektin përmbajtësor pa gabime.

2. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit

Kryetari i Komisionit- Duke marrë parasysh se ky komision është i ri dhe mbështetje teknike nuk kemi të mjaftueshme deri sa të lirohen disa zyra këtu në Kuvend. Kam pas takim edhe me Kryetarin e Kuvendit ku me ka premtuar, se po bën përpjekje që ne të bëjmë një zgjidhje në aspektin teknik. Për një afat të shkurtër nuk besoj që ka diçka në këtë drejtim. Të bëjmë një plan të punës së Komisionit por me mundësi të ndryshimit d.m.th ne mund të bëjmë një plan afatshkurtër (orari takimi etj) për dy javë ose 1 muaj por mos të jetë kjo e përfunduar për tërë vitin. Propozim konkret nuk kam por të mundohemi të mbajmë mbledhje kur deputetët të jenë në Prishtinë që të mos krijohen shumë shpenzime shtesë (ardhja, shkuarja, koha apo diçka tjetër). Prandaj kërkoj nga ju kërkoj inpute në këtë drejtim. Të gjejmë një konsensus të mundshëm në këtë drejtim.

Gjylnaze Sylaj- Plani punës mendoj se kanë përvojë komisionet si bëhen. 1) është përgjegjësia cilat veprime i bën komisioni 2) afati kohor muajt cilat aktivitete i kryen. Meqenëse sipas fushëveprimit dalin përgjegjës të komisionit, mbikëqyrja e ligjeve, mbikëqyrja e dokumenteve të politikave, buxheti, menaxhimi dhe administrimi. Në bazë të kësaj është edhe plani i punës dhe kjo është fleksibile se duhet ndryshuar.

Adem Salihaj- Ne kemi pak më shumë se një muaj këtë vit dhe duhet të kemi një plan deri në fund të këtij viti i cili të jetë një plan i thjeshtë që mos të ketë një përmbajtje të madhe. Kryetari me staf ose me dikë duhet të bëjë një projektplan për vitin 2010 që në fund të këtij viti ta miratojmë. Mund të marrim përvojë edhe nga komisionet tjera, punët që i kemi dhe dinamikën e kryerjes së këtyre punëve me afate me muaj dhe të bëhet sa më shpejt. Aty do të parashihet edhe shqyrtimet e çështjeve këtu në komision por edhe vizita në Forcën e Sigurisë në Ministri dhe personave përgjegjës këtu. Të gjitha këto do ta kenë planin dinamik të punës përveç çështjeve që dalin papritur këtu të cilat mund të jenë urgjente jashtë këtij plani. Besoj që stafi do të gjejë kohë për ta bërë këtë plan. Ta kemi një plan deri në fund të këtij viti dhe një projekt plan për vitin 2010 ta miratojmë deri në fund të këtij viti.

Rita Hajzeraj- Jam dakord që më shumë të merremi me planin e vitit 2010. Mund të bëjmë një plan afatshkurtër për këto një muaj e gjysmë sa kanë mbetur. Nuk e kemi shumë vështirë për ta bërë planin duke u bazuar në strategjinë legjislative të Kuvendit. Ndoshta do të kemi edhe projektligje që do të na vinë në komisionin tonë dhe më shumë të fokusohemi në monitorimin e tyre. Si komision i ri duhet të kemi takime të vazhdueshme me FSK-në. Jam e mendimit që të kemi bashkëpunim me dy komisionet, Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Komisionin për Mbikëqyrjen e

Agjensionit për Inteligjencë. Natyra e punës së këtyre dy Komisioneve i përafrohet edhe natyrës së punës të Komisionit tonë.

Zylfi Merxha- Të caktohet një Komision të përbërë nga tre anëtare dhe të punojnë për planin e vitit 2010.

Kryetari i Komisionit- Nga ky komision të nxjerrim një grup punues i cili do të mund të na propozoj një plan të punës. Së pari për punën e këtij viti e mandej duke u mbështet dhe në planin e këtij viti të vazhdoj të punojë edhe për planin e vitit të ardhshëm. Mbas diskutimeve u caktuan Kryetari dhe dy Nënkryetarët. Ditën e Martë u caktua si ditë për mbledhjet e Komisionit.

3. Te ndryshme

Kryetari Komisionit- Kam pas takim me Kryetarin e Kuvendit dhe propozimin tonë ata nuk e kanë shqyrtuar si Kuvend sepse me 2 Tetor është dashur të rezervohen vendet për Asamblenë Parlamentare të NATO-s. Më kanë thënë që në një afat shumë të shpejtë sepse dy mbledhje janë vjetore do të shqyrtohet kërkesa dhe Komisioni do të involvohet në këtë proces. Kryesia e Kuvendit ka kërkuar që mundësisht të reflektojë pozita edhe opozita

Gjynaze Sylja- Për mbledhjen e fundit kam qenë shumë e pakënaqur dhe ende jam e pakënaqur. Mënyra e marrjes së vendimeve ka qenë e gabuar, nuk ka qenë legjitime se unë dhe z. Adem Salihaj kemi dal dhe nuk ka mundur të zgjidhet pa votat tona sepse nuk pasur kuorum. Në të ardhmen duhet të mbahet një mbledhje në lidhje me këtë çështje që të mos kemi probleme në përzgjedhje të deputetëve në sesionin e NATO-s. Komisioni e ka një buxhet prej 10 mijë eurove dhe atë buxhet ne duhet ta shfrytëzojmë duke filluar prej muajit Janar, për konsultantë të jashtëm, ligjor apo ndihmë profesionale.

Kryetari i Komisionit-Përzgjedhja ka qenë në harmoni me ligjin duke marrë parasysh edhe prezencën edhe votimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12.40

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit
Berim Ramosaj

